

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “BLERJE DETERGJENTË PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BURGJEVE”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(FPP) 39224100-9, 33711900-6, 33711610-6;

VLERA E FONDIT LIMIT: 39,951,333 (tridhjetë e nëntë milion e nëntëqind e pesëdhjetë e një mijë e treqind e tridhjetë e tre) **lekë pa TVSH** ose **400,675** (katërqind mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë) **Euro pa TVSH** (Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë me datë 22.08.2024 është 99.71).

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 7

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”te ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit**.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, sa vlera e fondit limit në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “ Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.*

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, u përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se:Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës,

paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe ligjit si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.
 - b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit të këtij loti, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Ky kriter garanton Autoritetin Kontraktor se operatori ekonomik pjesëmarrës ka një veprimtari ekonomike të sukseshme dhe do të realizojë me sukses kontratën objekt prokurimi.

2. Operatori ekonomik duhet të deklarojë nëse është prodhues/distributor i autorizuar ose tregtuesi i autorizuar nga prodhuesi/distributori i mallrave për artikujt objekt prokurimi. Në rast kur OE nuk është prodhues i këtyre produkteve/artikujve, ai duhet të disponojë dhe të paraqesë: Autorizim Prodhuesi dhe/ose Kontratë Funizimi/Bashkepunimi nga një Distributor i autorizuar, në të cilat duhet të jenë përcaktuar emertimet e produkteve objekt prokurimi. Autorizimi apo kontrata duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit apo distributorit të autorizuar.

Argumentimi: Në bazë të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 40, pika 8 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”, me anë të këtij kriteri duke marrë në konsideratë llojin e produkteve dhe sasinë e tyre Autoriteti Kontraktor kërkon të ketë siguri në mundësitë që ka operatori ekonomik për funizimin në mënyrë të vazhdueshme të produkteve cilësore, në përputhje me specifikimet teknike dhe brenda afatit sipas kërkesave të AK-ve.

3. Operatori ekonomik për secilin nga produktet do të paraqesë flete-analize të lëshuar nga një laborator i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma c) dhe neni 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar; nenit 5 pika 1/a të ligjit Nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit akrediton: a) laborator testues, mjekesor dhe kalibrues”, nenin 8 të Ligjit nr.10216, datë 21.01.2010 “Për detergjentët”, VKM-në nr.220 datë 28.3.2012 “Për përcaktimin e standardeve, metodave të testimit dhe kufijtë e lejuar për biodegradimin e detergjenteve dhe vlerësimin e rrezikut për lëndët tensioaktive në detergjente”, ligjin nr. 10480, datë 17.11.2011 “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të përbashkët nr.3330, datë 20.03.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe nr.145, datë 16.03.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë për rezultatet zyrtare dhe të sakta të produkteve që ata ofrojnë, për të cilat duhet të vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet standarde të procedurës objekt prokurimi.

4. Operatori ekonomik për secilin nga mallrat objekt prokurimi duhet të paraqesë dokumentin me të dhënat e sigurisë (MSDS) të lëshuara/publikuara nga prodhuesi/t.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/ c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, nenit 13 dhe 15 të Ligjit nr.27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve”, VKM nr.9 datë 09.01.2019 “Për rregullat e detajuara dhe metodat për kryerjen e vlerësimit të sigurisë së kimikatit, si edhe kërkesat specifike, përmbajtja dhe formati i dokumentit me të dhënat e sigurisë”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të paraqesin dokumentin me të dhënat e sigurisë të cilat provojnë përmbushjen e karakteristikave teknike të mallrave objekt të prokurimit. Nisur nga fakti se disa nga mallrat objekt të kësaj kontrate do të përdoren në institucione të ekzekutimit të vendimeve penale, duke patur në fokus ruajtjen e kushteve të duhura të higjienës sipas kuadrit rregullator në fuqi, duhet të jenë konform specifikimeve teknike të kërkuara dhe kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, karakteristikat teknike të kërkuara.

5. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë **një deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** në adresat e përcaktuara nga autoritetet kontraktore.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër shërbimin e transportit të mallit në adresat e përcaktuara të AK-ve. Ky kriter është vendosur duke marrë parasysh numrin e Autoriteteve Kontraktore dhe shpërndarjen e tyre gjeografike.

6. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë të paktën 1 (një) automjet (ATP) për transportin e mallrave, të cilat duhet t'i ketë në pronësi ose me qira.

Per sa me siper operatori ekonomik te paraqesë nje deklarate perkatese sipas formatit te meposhtem:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Kapaciteti mbajtes	Statusi
1				Pronesi/qira/perdorim

Per mjetin e kerkuar duhet të paraqiten dokumentat si më poshtë:

- Nëse është ne pronësi, të disponohet dokumenti certifikatë pronësie e mjetit, leje qarkullimi e vlefshme, çertifikata e kontrollit teknik, polica e vlefshme e sigurimit të detyrueshëm të mjetit.
- Nëse është me qira/ huapërdorje, të disponohet kontrata e qirasë/ huapërdorjes, dokumenti që vërteton regjistrimin leje qarkullimi, çertifikata e kontrollit teknik, si dhe polica e vlefshme e sigurimit të detyrueshëm të mjetit.

Shënim: Kriteri nr.6 konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit te vetedeklarimit shtojca 8. Dokumentet e kerkuara me siper do te paraqiten ne rast se operatori kualifikohet i pari, por perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit ose nese kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, Autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet për mjetet që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit sipas afatit të lëvrimit. Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar një minimum të mjeteve që operatori ekonomik duhet të ketë ne dispozicion për zbatimin e kontratës, duke marrë parasysh sasinë e mallit që kërkohet, afatin e lëvrimit të tij nga data e nënshkrimit të kontratës brenda afatit e marreveshjes kuadër dhe vendodhjes së AK përfitues.

7. Operatori ekonomik, për të realizuar shperndarjen e mallrave objekt prokurimi, si dhe shërbimin e transportit duhet të ketë punësuar minimalisht 2 (dy) punonjës, si më poshtë:

Stafi	Nr.
Shofer	1
Punetore te thjeshte	1
Total	2

Për punonjësën shofer të paraqitet:

- Leje drejtimi përkatëse e mjetit.
- Kontrate pune

Për punonjësën punëtor i thjeshtë të paraqitet:

- Kontrate pune

Shënim Kriteri nr.7 konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit te vetedeklarimit shtojca 8. Dokumentet e kerkuara me siper do te paraqiten ne rast se operatori kualifikohet i pari, por perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit ose nese kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë ofertues të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Numri minimal prej 2 punonjësish, përkatësisht një shofer dhe një puëtorë të thjeshtë, që operatori ekonomik duhet të ketë ne dispozicion, është kërkuar duke u bazuar në numrin e automjeteve që janë kërkuar për kryerjen e transportit të mallrave objekt prokurimi si dhe një punonjës për shkarkimin e mallrave në ambjentin e caktuar nga Autoriteti Kontraktor.

8. Operatori ekonomik per secilën nga produktet objekt prokurimi duhet të paraqesë nga një mostër të cilat duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcë nr. 5 të DST-së të gjithë artikujt objekt prokurimi ditën e hapjes se ofertave duhet te paraqesë mostrat te cilat duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike në DST. *Mostrat duhet të paraqiten ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit në ambjentet e OBP-së, në adresën ”Rruga “Reshit Collaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë)”*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se mallrat e ofruara prej tyre plotësojnë kërkesat e specifikimeve teknike të kërkuara në dokumentet standarde të tenderit. Duke marrë parasysh llojin e mallrave objekt prokurimi dhe Autoritetin Kontraktor kërkues është e rëndësishme që të garantohet cilësia e mallrave që operatorët ekonomik ofrojnë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike :

Specifikimet teknike janë hartuar nga Autoriteti Kontraktor përfitues për mallrat duke përlllogaritur sasi të e nevojshme për objektin që prokurohet, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Çdo standard i kërkuar apo çdo referencë marke të mallrave objekt prokurimi autoriteti kontraktor do të pranojë edhe ekuivalentin e tij.

Ky shënim është në përputhje me nenin 36, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

NJËSIA E PROKURIMIT: